



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:007128

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03383449

**P. nr. 122/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit **B. P.** nga fsh. . . K Gjakovë, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/I .nr.08/22 të dt.23.03.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **29.08.2022** në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit, me datën 31.08.2022 morri dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. P. nga fsh. . . K-Gjakovë**, data e lindjes . . ., i biri i S. dhe i nënës H., e gjinisë K. ,ka të kryer 3 klasë të shkollës fillore, i papune, i gjendjes se dobët ekonomike, ,i pa martuar , shqiptar , shtetas Republikës së Kosovës, me ID . . .

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

**-më datë 14.01.2022 në fshatin . . ., Komuna Gjakovë**, pa autorizim posedon narkotik, substanca psikotrope ose analoge, ne atë mënyrë që gjatë bastisjes se shtëpisë dhe lokaleve përcjellëse të pandehurit, nga ana e zyrtarëve policor janë gjetur: substanca narkotikë llojit mariuanë në peshë prej 0.51 gram, një (1) qese najloni e mbushur narkotik të llojit mariuanë në peshë prej 1.34 gram, katër (4) fara- mbetje mariuan , një (1) qese tjetër najloni e mbushur me narkotik te llojit marianë në peshë prej 161 gram dhe gjashtë (6) qese najloni të mbushura me narkotik të llojit marihuan në peshë prej 79 gram, ku pas ekspertimit kjo substancë ka rezultuar te jetë ne peshë përgjithshme prej 216.08 gr. të cilat me pas janë sekuestruar nga zyrtarët policor.

**-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës,**

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,17,38, 43.46,47, 48,49 69,70 , 79 dhe nenit 269 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 365 te KPPK-së te akuzuarit i shqipton :

**DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale si dhe si dënimin me gjobë në shumë prej **300 (treqind) euro**, të cilën dënim është i detyruar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas neni 43 par.3 të KPRK-së, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej **20 (njëzet) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20 (njëzet).-€**

Detyrohet i akuzuari që në emër të të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë

Gjykata bazuar në nenin 269 par.3 të KPRK-së lidhur me nenin 115 të KPPK-së, të akuzuarit i:

**Konfiskohet** substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë prej me peshë 216.08 gram, e sekuestruar me dt. 14.01.2022, e që është objekt i kësaj veprë penale.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/I.nr.08/22 të dt.23.03.2022, ka akuzuar të akuzuarin B. P. nga fsh. . . K Gjakovë, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269/1 të KPRK-së, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 29.08.2022, prokurori i shtetit Anton Hasanaj, lexon aktakuzën PP/I. nr.08//22 të dt.23.03.2022,, me ç' rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari B. P., në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer, me qenë se në atë kohë kam qenë përdorues i narkotikeve, kërkoj falje nga gjykata për veprimet e mia, premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, andaj i propozoi gjykatës që të marrë parashikimet rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, gjendjen e dobët ekonomike, faktin se më parë nuk kam rënë ndesh me ligjin të më shqiptojë një dënim më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu të akuzuarit B. P., pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favorin e pranimin të fajësisë të sqaruara nga ana e gjykatës, duke marrë parasysh se aktakuza ka mbështetje në provat personale dhe material në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari, andaj i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor konform dispozitivave ligjore të dënohet dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale, njëkohësisht konform nenit 269/3 të KPPK-së. = substanca narkotike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, në peshë 216.08 gr. Te konfiskohet si objekt i kryerjes së veprës penale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. P. : **-më datë 14.01.2022 në fshatin . . . , Komuna Gjakovë**, pa autorizim posedon narkotik, substanca psikotrope ose analoge, ne atë mënyrë që gjatë bastisjes se shtëpisë dhe lokaleve përcjellëse të pandehurit, nga ana e zyrtarëve policor janë gjetur: substanca narkotikë llojit mariuanë në peshë prej 0.51 gram, një (1) qese najloni e mbushur narkotik të llojit mariuanë në peshë prej 1.34 gram, katër (4) fara- mbetje mariuan , një (1) qese tjetër najloni e mbushur me narkotik te llojit marianë në peshë prej 161 gram dhe gjashtë (6) qese najloni të mbushura me narkotik të llojit marihuan në peshë prej 79 gram, ku pas ekspertimit kjo substancë ka rezultuar te jetë ne peshë përgjithshme prej 216.08 gr. të cilat me pas janë sekuestruar nga zyrtarët policor. **-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës,**

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese gjykata konsideron faktin se i njëjti ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se është i moshës relativisht të re, pranimin e vullnetshëm i fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, gjendjen e dobët ekonomike, pendimin e tij ,premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar ,të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së. Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërmëdhjetë ) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , në të cilin dënim në rast të revokimit të dënimit duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në parabu **300 (treqind) euro**, me të cilin sanksion sipas gjykatës do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se ky sanksion do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit Marihuanë me peshë prej 216.08 gram, e sekuestruar me dt. 14.01.2022, e që është objekt i kësaj vepre penale., u murr komform nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së .  
Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P.nr.122/22 më datë 31.08 .2022**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej 15 **ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate